



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 10.03.2025

Nr: 13

Ora: 10:30

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 05, DATË 06.03.2025
TË DEPOZITUAR NGA PARTIA “MINORITETI ETNIK GREK PËR TË ARDHMEN-
MEGA”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 10.03.2025, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” (MEGA)

OBJEKT: Shfuqizimi i Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 228, datë 03.03.2025 “Për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” (MEGA) me kryetar z. Kristaq Kiço”.

Palë e Interesuar: Z. Kristaq Kiço, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga av. Thoma Miço

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 10.03.2025 Nr: 13
Ora: 10:30



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 05, datë 06.03.2025 të depozituar nga Partia “Minoriteti Grek për të Ardhmen”- MEGA”.

VËREN:

Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” (MEGA), ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 05 regj., datë 06.03.2025.

Në mbledhjen e datës 10.03.2025, pas relatimit të z. Ledio Braho, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 05, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 05, datë 06.03.2025, të paraqitur nga Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”- (MEGA).
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 10.03.2025, ora 11:45.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar